



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2616, datë 10.09.2015

Për

“Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.09.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Rregullore për ofrimin e shërbimit universal postar”

Dokumentacioni i Grupit të Punës përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;
- Dokumenti: “Rregullore për ofrimin e shërbimit universal postar”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 12, pika 1 dhe neni 14 i Ligjit Nr.46, datë 7.5.2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 46/2015*);
2. Pika 3 e nenit 114 të Ligjit Nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
3. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” i ndryshuar (*ligji nr. 8485*);
4. Rregullore e brendshme e AKEP, miratuar me Vendim nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Ligji Nr. 46/2015, 2015 “Për shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 7.05.2015. Ky ligj zëvendëson Ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999, “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në bazë të pikës 67 të tij, Ligji 46/2015 hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ligji 46/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.85, datë 26.05.2015.
2. Pika 2 e nenit 65, e ligjit 46/2015 citon: “Ngarkohet AKEP-i që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 12, pika 1; 14, pika 4; 16, pika 1; 19, pikat 2 dhe 8 ; 31, pika 5; 33, pika 1; dhe 55, pika 6, të këtij ligji”.
3. Bazuar në përcaktimet e ligjore të mësipërme, AKEP me Urdhërin nr. 1482, date 23.06.2015, ka ngritur një Grup Pune (GP) për përgatitjen e kuadrit rregullator të shërbimeve postare sipas Ligjit 46/2015. GP ka përgatitur dokumentin “Rregullore për ofrimin e shërbimit universal postar” për këshillim publik me palët e interesuara. Dokumenti i përgatitur ka si objekt të krijojë kuadrin rregullator për përmbushjen e kërkesave ligjore të neneve 12, pika 1; 14, pika 4 dhe 33, pika 1, të Ligjit 46/2015
4. Në përgatitjen e dokumentit GP ka marrë në konsideratë përvojën në vendet e BE dhe rajonit si dhe kushtet Shqiptare në ofrimin e shërbimit postar dhe dokumenti i përgatitur përmban:
 - a) rregulla për të gjithë ofruesit e shërbimit universal me qëllim sigurimin e vazhdueshem të ofrimit të shërbimit universal postar;
 - b) treguesit e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal postar dhe kërkesa të detajuara për ofrimin e shërbimit/eve universale postare
 - c) lista e standardeve Shqiptare për matjen e cilësisë së ofrimit të shërbimit universal
 - d) rregulla për dhënien e aksesit në rrjetin e ofruesit të shërbimit universal postar.

5. Dokumenti “Rregullore për ofrimin e shërbimit universal postar” është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm në tregun e shërbimit postar. Dokumenti nxirret për këshillim publik dhe AKEP mirëpret komente nga palët e interesuara.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar me lart, bazuar në pikën 1 të nenin 10, të ligjit 46/2015,

V E N D O S:

1. Të miratojë nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “*Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar*”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për periudhën 10.09.2015-20.10.2015. Komentet e palëve të interesuara të paraqiten me shkrim në adresën zyrtare të AKEP brenda datës 20.10.2015.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar*”, të publikohen në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**